

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ECOALB” SHPK

Themeluesit qe nenshkruan me poshte si vijon:

- 1) Z. KLAOS PRIFTI**
- 2) Z. HENRI DABERDINI**

Qe ne vijim do te quhen Ortaket e Shoqërisë “ECOALB” SHPK.

Sot me date 27/03/2023, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria “ECOALB” SHPK., ka si objekt veprimtarie:

1. Import-eksport te lendeve te pare per prodhimin e nenprodukteve te autoveturave dhe kamionave;
2. Prodhim i produkteve te teknologjise se gjelber per perdorim tek autoveturat dhe kamionat me motorr me djegie te brendshme;
3. Tregtimi i ketyre produkteve me shumice dhe pakice.
4. Import-eksport i nenprodukteve te prodhuara.;
5. Import eksporti, blerja e mallrave dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me objektin e lartpërmendur, ofrimin e shërbimeve që lidhen me të;
6. Mund të hyjë në negociata dhe biznes me kompani të tjera që kanë të njëjtin objekt aktiviteti për të bërë fitime në fushën e veprimtarisë së saj;

7. Importojnë tregtinë e prodhimit, transportit dhe eksportit të palëve të treta me materialin ose porosinë e saj;
8. Të marrë pjesë në ankande, kontrata publike ose lëshime të zhvilluara nga organet kompetente shtetërore sipas legjislacionit në fuqi;
9. Të fitojë veprimtari tregtare me transferim sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

1. Ortaket vendosen qe shoqerine t'a emertojne "ECOALB" SHPK
2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njesia Bashkiake n. 11 – Rruga Princ Vidi 16/ Tirane / Shqiperi.
3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, dege, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

10. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
11. Me vendim te Asamblese se Pergjitheshme mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast do te pershtatet Akti i Themelimit dhe Statuti e shoqerise, si dhe do te behet regjistrimi i saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
12. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
13. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në një shoqëri tjetër ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.
5. Ortaket marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetëm ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.
6. Ortaket kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregëtare të shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

1. Shoqëria tregëtare "ECOALB" SHPK ka një kapital themeltar në shumën 100 000 (njëqind mijë) Lekë.
2. Shoqëria do ketë dy kuota, ku secili ortak zotëron nga një kuota.
3. Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - Z. Klaos Prifti, zotëruar i një kuote, me vlerë të përgjithshme 50 000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që përbën njëkohësisht 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë;
 - Z. Henri Daberdini, zotëruar i një kuote, me vlerë të përgjithshme 50 000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që përbën njëkohësisht 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë;

Kreu IV
PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit të saj ne Regjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne Tirane, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 8

1. Shoqeria do te administrohet nga administratori z. Klaos Prifti per nje periudhe **5 (pesë)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegeje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakeve te saj .
2. Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.
3. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

KLAOS PRIFTI

HENRI DABERDINI

Klaos Prifti K. Prifti

Henri Daberdini H. Daberdini